



**SUBJEKTI:** FENIX I.C. SH.P.K.

**ADRESA:** ELBASAN, LABINOT FUSHË, MENGËL, KOMUNA LABINOT-FUSHË,  
ISH-FRIGORIFERI I MADH, ELBASAN

**PËRGATITI RAPORTIN, SUBJEKTI LOERMA SH.P.K., NIPT L02928204T I LICENSUAR**

- 1. LN-8126-06-2014 VLERËSIM I NDIKIMIT NË MJEDIS DHE AUDITIM MJEDISOR.**
- 2. LT 099 15.01.2020 LABORATOR TESTUES I AKREDITUAR.**

**SHTATOR 2021**

## I. BAZA LIGJORE

Ky raport është hartuar duke u mbështetur kryesisht në Ligjin nr.10 431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit":

### KREU VI

#### MONITORIMI I GJENDJES SË MJEDISIT

##### Seksioni 1 Gjendja e mjedisit

##### Neni 41

#### **Monitorimi i gjendjes së mjedisit**

1. Monitorimi i gjendjes së mjedisit është vëzhgimi dhe regjistrimi, sipas një plani dhe rregulli të caktuar, i cilësisë së mjedisit dhe i ndryshimeve të gjendjes së përbërësve të tij. Në veçanti, ai përfshin:

- a) cilësinë e ujërave sipërfaqësore;
- b) cilësinë e ujërave nëntokësore;
- c) cilësinë e ajrit;
- ç) mbetjet;
- d) zhurmat;
- dh) rrezatimet;
- e) cilësinë e tokës;
- ë) florën, faunën, biodiversitetin, pyjet;
- f) ndikimet e sektorëve ekonomikë mbi përbërësit e mjedisit;
- g) monitorimin e fenomeneve natyrore dhe ndikimin e mundshëm të tyre mbi mjedisin;
- gj) monitorimin e ndikimeve të ndotjes së mjedisit mbi shëndetin e njeriut.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat dhe procedurat për hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit.

##### Neni 42

#### **Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit**

1. Në zbatim të nenit 41 të këtij ligji, ngrihet Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit, i cili shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit.

2. Organizimi dhe funksionimi i rrjetit dhe mënyra, procedura dhe forma e paraqitjes së të dhënave në këtë rrjet miratohen nga Këshilli i Ministrave.

**Monitorimi i përputhshmërisë**

Neni 44

**Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë**

1. Operatori i veprimtarive, të përfshira në kategoritë A, B dhe C, të referuara në nenin 29 të këtij ligji, monitoron shkarkimet e veprimtarisë së tij, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për lejet e mjedisit dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit.
2. Operatori i referuar në pikën 1 të këtij neni monitoron burimet e shkarkimit të veprimtarisë së vet dhe kryen monitorime të tjera, duke përdorur pajisje dhe instrumente të miratuara, përmes procedurës për verifikimin e matjeve, të parashikuara në legjislacionin e posaçëm dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit, si dhe mban këto pajisje e instrumente në një gjendje të përshtatshme pune.
- 3. Operatori mund të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar.**
4. Rezultatet e vetëmonitorimit u jepen autoriteteve përkatëse në përputhje me legjislacionin për lejet mjedisore dhe me kushtet e përfshira në lejen përkatëse mjedisore.

- ❖ V.K.M. nr.453, date 12.09.2002 "Per normat e shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise"
- ❖ V.K.M. nr. 103, date 31.03.2003 "Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise"
- ❖ Udhëzimi nr. 8, date 27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara"
- ❖ Udhëzimi Nr.1037/1, date 12.4.2011 "për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmave mjedisore"
- ❖ V.K.M. nr.177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseseve ujore pritese"
- ❖ Ligji nr. 9824, date 01.11.2007 "Per akreditimin e organizmave te vleresimit te konformitetit ne Republiken e Shqiperise"

## II. TË DHËNA MBI SUBJEKTIN "FENIX I.C." SH.P.K.

- *Vendodhja:* ELBASAN, LABINOT FUSHË, MENGËL, KOMUNA LABINOT-FUSHË, ISH-FRIGORIFERI I MADH, ELBASAN.
- *Leje Mjedisore Tipi C:* LC-6688-11-2015, K.T.Nr. 36 Datë 24.11.2015  
Nr. Identifikimi LMC6688EL20151124
- *NIPT:* L42731201L
- *Aktiviteti që monitorohet:* "Prodhim i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to"
- *Kapaciteti:* 5 ton/ditë
- *Sipërfaqja totale:* 20287 m<sup>2</sup>
- *Sipërfaqje e zënë me ndërtim:* 10854.3 m<sup>2</sup>

Subjekti "Fenix I.C." sh.p.k. me numër unik identifikimi NIPT: L4273121I dhe administrator Astrit SHOTI, ushtron aktivitetin e tij në ndërtesat e ish-Frigoriferit të Madh nr.1480, në Mengël, Njësia Administrative Labinot Fushë, Bashkia Elbasan, ambiente të cilat janë rikonstruktuar dhe përshtatur për realizimin e veprimtarisë së tij. Veprimtaria e subjektit "Fenix I.C." sh.p.k. konsiston në procesin e përpunimit të aquges, specie detare e cila njihet me emrin shkencor *Engraulis encrasicolus*.

Prosesi i përpunimit të aquges konsiston në maturimin e enzimës së shëllirës, i cili vijon me filetimin e peshkut vetëm kur të ketë arritur parametrat e mëposhtëm organo-leptikë dhe fiziko-kimkë:

<b>KARKTERISTIKAT ORGANOLEPTIKE:</b>	
<b>1. Ngjyra</b>	kafe - e kuqërremtë
<b>2. Erë</b>	tipike, mungesa e aromave të jashtme (të prishura, të kalbura)
<b>3. Shije</b>	tipike, e kripur, mungesë e një shije të jashtme (e prishur, e kalbur)
<b>4. Konsistenca (Qëndrueshmëria)</b>	konsistenca e forte


**KARAKTERISTIKAT FIZIKO-KIMIKE:**

<b>1. Lagështia</b>	<49%
<b>2. Erë</b>	14-18%
<b>3. %SFA</b>	>25.8%
<b>4. Aw</b>	< 0.75
<b>5. Qendrueshmeria</b>	<100ppm

**Procesi i pastrimit dhe Filetimit të Açuges**

Per filetimit zakonisht perdoret Acuge e fresket dhe e trajtuar mire qe ne momentin e peshkimit. Filetimi realizohet neper tavolina inoxi dhe ne prani te ujit te qarkullueshem ku cdo punetore ka rubinetin e saj. Tavinat jane te ndertuara ne menyre te tille qe produkti i filetuar te perfundoje ne kazanin e grumbullimit dhe mbetjet te grumbullohen ne kazanin e mbetjeve teknologjike. Pasi realizohet larja e mire e filetes grumbullohen ne kazane ne uje te rrjedshem duke shtuar here pas here akull. Pasi filetohet trajtohen per 2-3 ore ne kazane me uje dhe kripe behen gati per procesin e metejshem te marinimit

Pas procesit të filetimit dhe marinimit të açuges, produkti pasi ka arritur maturimin e duhur, është i gatshëm për mbushjen nëpë enë të ndryshme si vasketa ose kuti të madhësive të ndryshme. Pas procesit të mbushjes dhe mbylljes së vasketave, procesi i fundit është etiketimi i produktit sipas kriterëve të procesit të etiketimit.





**Produkti përfundimtar- *Açuge e marinuar***

Subjekti tashmë ka arritur parametrat e projektit në sasinë e lëndës së parë që përpunon si dhe, në sasinë ashtu edhe cilësinë e produktit të prodhuar. Ai ka programe për të përmirësuar treguesit e humbjeve teknologjike si dhe të impakteve në mjedis.

## **II. KRITERET PËR MENAXHIMIN E AKTIVITETIT**

Subjekti ka të punësuar një menaxher të arsimuar në përputhje me natyrën e punës dhe me përvojë, si person përgjegjës.

Të gjithë punëmarrësit e këtij subjekti të cilët kryejnë detyra specifike janë të kualifikuar, të trajnuar dhe kanë eksperiencë për punën që ato kryejnë.

Drejtuesi i subjektit ka krijuar dhe mirëmban dokumentacionin mbi menaxhimin e mjedisit, në përputhje me kërkesat e autoritetit kompetent.

Subjekti ka siguruar zbatimin e masave që parandalojnë ndotjen e mjedisit dhe shkarkimet mbi normën e lejuar për ujin dhe për tokën, pakësimin dhe ripërdorimin e mbetjeve që gjeneron veprimtaria si dhe respektimin e kërkesave dhe të kushteve të lejes mjedisore.


Respektohen rigorozisht rregullat higjeno- sanitare dhe të sigurimit teknik të punonjësve dhe të mos ushtrohet asnjë ndikim negativ në shëndetin e popullatës që banon përreth subjektit.

Respektohen rigorozisht kërkesat për mbrojtjen nga zjarri, duke përdorur mjete përkatëse të rekomanduara si dhe të mbahet rregullisht lidhje me repartet e specializuara që ndodhen në juridiksionin e qarkut Elbasan.

Respektohen standartet e normativat për nivelin e zhurmave të lejuara.

### **III. SHKARKIMET E ELEMENTËVE NDOTËS NË MJEDIS**

Laboratori "LOERMA" sh.p.k. përdor metoda dhe pajisje bashkohore për realizimin e matjeve dhe analizave për shkarkimet në kanalizime, për parametra të nivelit të zhurmave të gjeneruara dhe elementëve të mikroklimës si temperaturës, presionit dhe lagështisë relative.

	<b>RAPORT TESTIMI-UJË</b>		
Kodi : LOERMA FP011-2-1	Rishikimi Nr 4	Data e rishikimit 02.11.2020	Faqe 1 nga 2



**LT 099 15 01 20**

Nr..... prot

Elbasan, më .....

**Raport Testimi**

*Emri i subjektit:* FENIX I.C. SH.P.K.

*Adresa e subjektit:* Elbasan, Labinot Fushë, Mengël, Ish-Frigoriferi i Madh

*Personi kontakt i subjektit:* Pranvera Guxho

*Kodi I kampionit:* LEM-001-FI-04-09-21.

*Vendi i marrjes së kampionit (Vendndodhja, Koordinatat):* Elbasan, Labinot Fushë, Mengël, Ish-Frigoriferi i Madh

*Data dhe ora e marrjes së kampionit:* 04 Shtator 2021; Ora 13:30

*Personi që merr kampionin:* Pranvera Guxho

*Data e pranimit të kampionit në laborator:* 04 Shtator 2021

**Rezultatet e testimit**

Testi	Standardi/ Metoda e provës	Rezultati	Pasiguria e matjes	Normat e lejuara
Përcaktimi i pH	SSH ISO 10523:2008	7.5	±0.011 pH(k=2)	6 - 9
Përcaktimi i Lëndës në pezulli	SSH EN 872:2005	19.6 mg/l	NA	50 mg/l
Përcaktimi i nevojës biologjike për oksigjen (BOD <sub>5</sub> )	ISO 5815-2:2009	13.4mg/l	±2.8	50 mg/l
Përcaktimi i	ISO 15705:2002	67mg/l	±4.9	250 mg/l

LOERMA SH.P.K.

e-mail: loerma 2009@gmail.com

Cel: +355 (0) 69 20 46 660 dhe/ose +355 (0) 67 40 57 777

Faqe 8 deri 30



**SUBJEKTI "FENIX I.C." SH.P.K.**

nevojës kimike për oksigjen (COD)				
Përcaktimi i Nitratit (NO <sub>3</sub> <sup>-</sup> )	PT017-001-NO <sub>3</sub>	4.80 mg/l	±0.10	10 mg/l
Përcaktimi i Fosforit Total (P)	PT017-001-P	1.30 mg/l	± 0.023	5 mg/l
Përcaktimi i Vajrave Bimore	Method 10056	2.10 mg/l	NA	10 mg/l

Analizat u kryen në datë: 04 Shtator 2021

Analizat u kryen nga: Albana Pisha

Aprovuar nga Drejtuesi i Laboratorit: Shpresa Banja

Shënim:

Rezultatet e pasqyruara në këtë fletë analizë, i përkasin vetëm kampionit të analizuar, në kohën dhe kushtet e kryerjes së mostrimit dhe të analizës. Përgjegjësinë për kampionimim e ka subjekti.

**Opinione dhe interpretime mbi rezultatet e analizës së pasqyruar.**

Subjekti "FENIX.I.C" sh.p.k nuk bën shkarkime të tjera në rrjetin e kanalizimeve përveç atyre të deklaruara në dokumnetacionin e dorëzuar .

Analiza e pH u bë në vënd (preferohet të bëhet në vëndin e marrjes së kampionit) konform standartit BS EN ISO 5667-3:2018 Më pas u rianalizua dhe në laborator me aparatit photoLab 7600 mbasi u kontrollua fillimisht kalibrimi i aparatit me solucion standart te çertifikuar me pH 7. Kampioni u soll në laborator nga klienti në **shishe të errët prej qelqi me volum 2L**.

Klienti kërkoi të bëhet përcaktimi i përmbajtjes së 7 elementëve : pH; Lëndë në pezulli, BOD 5, COD, Vajra bimore, Nitrat total, Fosfor total.

Standartit BS EN ISO 5667-3:2018 përcakton teknikat për ruajtjen e kampionit dhe tipin e kontenjerit që duhet përdorur.

- a. **Për lëndët në pezulli** kampioni mund të merret në shishe plastike ose qelqi dhe mund të analizohet brënda 2 ditëve. Kampioni u anaizua sapo erdhi në laborator
- b. **BOD<sub>5</sub> dhe COD** kampioni mund të merret me shishe plastike ose me shishe qelqi (për COD rekomandohet edhe PP polipropilen). Për BOD<sub>5</sub> nëse kampioni mbahet në errësisrë ose përdoret shishe me ngjyrë të errët duhet analizuar brenda 24 orëve, nëse ngrihet në frigorifer në temperaturë – 18 °C kampioni mund të ruhet deri në një muaj (ose 6 muaj nëse është > 50 mg/l). Për COD nëse acidifikohet në pH 1-2 apo të ngrihet në frigorifer

**SUBJEKTI "FENIX I.C." SH.P.K.**

---

në temperaturë – 18 °C kampioni mund të ruhet deri në 6 muaj Kampioni u anaizua sapo erdhi në laborator

- c. **Për vajrat bmore** kampioni u acidifikua me HCL në pH 1 deri në pH 2. Shishja duhej të mbushej rreth 90%, në mënyrë që të ketë hapësirë të mjaftueshme
- d. **Për fosforin total.** Për koncentrimet normale duhet të përdoret PE-HD, PTFE ndërsa për koncentrimet të ulta PFA, FEP .Nëse kampioni acidifikohet me H<sub>2</sub>SO<sub>4</sub> /HNO<sub>3</sub> deri në vlerë pH 1-2 mund të ruhet deri në një muaj. Kampioni u anaizua sapo erdhi në laborator
- e. **Nitratet.** Nëse do të acidifikohet me HCl në pH 1-2 mund të ruhet nga 24 orë në një muaj.Nëse mbahet në frigorifer në temperaturë – 18 °C kampioni mund të ruhet deri në 8 ditë. Kampioni kur erdhi në laborator kishte pH 7 dhe nuk ishte i ngrirë. Kampioni u anaizua sapo erdhi në laborator

Duke qenë se, nuk janë zbatuar kriteret për marrjen, ruajtjen dhe transportin e kampionit, kampioni është nën përgjegjësinë e plotë të entit/klientit dhe laboratori nuk mban përgjegjësi për të.

Kampioni u mor në pikën fundore të shkarkimit "FENIX.I.C" nuk duhet në asnjë rast të vetëm të shkarkojë në rrjetin e kanalizimeve substanca që shkaktojnë reaksione kimike apo ujëra të ndotura me përmbajtje të tretësve organikë.

"FENIX.I.C" shpk nuk ka shkarkime në ujërat sipërfaqësore me përjashtim të ujërave të reshjeve.

DREJTUESI I LABORATORIT

MENAXHERI I CILËSISË


**Shpresa BANJA**

**Fuat BANJA**

(vula)

Laboratori LOERMA sh.p.k. **Deklaron se, ky Raport testimi/analize nuk mund të riprodhohet përveç i tërë, pa aprovimin me shkrim të laboratorit.**

**FUND RAPORT PROVE**

 Laboratori LOERMA:Lagja "Aqif Pasha", Rruga E Re, Pallati 500/3, Kati I, Elbasan e-mail: <a href="mailto:loerma@gmail.com">loerma@gmail.com</a> :Tel: +355 69 204 6660	<b>RAPORT TESTIMI TË NIVELIT TË ZHURMËS</b>
Kodi : LOERMA FP011-2-3	Faqe 2 nga 2



**LT 099 15 01 20**

Nr..... prot

Elbasan, më.....

**Raport Testimi**

*Emri i subjektit:* FENIX I.C. SH.P.K.

*Adresa e subjektit:* Elbasan, Labinot Fushë, Mengël, Ish-Frigoriferi i Madh

*Personi kontakt i subjektit:* Pranvera Guxho

*Vendi i kryerjes së matjeve të nivelit të zhurmës:(Koordinatat):* Të vendosura në tabelë

*Data dhe ora e kryerjes së matjes:* 04 Shtator 2021

Rezultatet e testimeve.

Nr	Vendi	Elementët	Fusha e matjes së instrumentit	Rezultati dB	Pasiguria e matjes	Metoda /standarti	Norma e lejuar	Temp. (°C) Lagështia %	Data	Ora
1	X1:4554561.303 Y1:4426135.833 (Bezdi [shqetësim] serioz gjatë ditës dhe mbrëmjes)	Përcaktimi i nivelit të zhurmës në Mjedis	20-143 dB	52.3 LA <sub>eq</sub> (dBA)	0.5 dB	SSH ISO 1996-2:2017	55 dBA	32°C 19.2%	04-09-21	11 <sup>00</sup> -12 <sup>00</sup> Dhe 20 <sup>00</sup> -21 <sup>00</sup>
	X2:4554427.519 Y2:4426080.530 (Bezdi [shqetësim] i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes)	Përcaktimi i nivelit të zhurmës në Mjedis	20-143 dB	47.01 LA <sub>eq</sub> (dBA)	0.5 dB	SSH ISO 1996-2:2017	50 dBA	32°C 19.2%	04-09-21	11 <sup>00</sup> -12 <sup>00</sup> Dhe 20 <sup>00</sup> -21 <sup>00</sup>

LOERMA SH.P.K.

e-mail: [loerma2009@gmail.com](mailto:loerma2009@gmail.com)

Cel: +355 (0) 69 20 46 660 dhe/ose +355 (0) 67 40 57 777

Faqe 11 deri 30

**SUBJEKTI "FENIX I.C." SH.P.K.**

2	X:4554438.505 Y:4426119.682	Niveli i zhurmës në vendin e punës	20-143 dB	58.75 $L_{EX,Sh}$	0.5 dB	SSH EN ISO 9612:2009	70 dB	32°C 19.2%	04-09-21	08 <sup>00</sup> -16 <sup>00</sup>
---	--------------------------------	------------------------------------	-----------	----------------------	--------	----------------------	-------	---------------	----------	------------------------------------

Analizat u kryen në datë: 04.09.2021

Analizat u kryen nga: Albana Pisha

Aprovuar nga Drejtuesi i Laboratorit: Shpresa BANJA

**Opinione dhe interpretime mbi rezultatet e analizës së pasqyruar.**

*Referenca me politikën Kombëtare dhe Ndërkombëtare:*

- Ligji Nr. 9774 date 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmave mjedisore",
- Udhëzimi Nr.1037/1, date 12.4.2011 "për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmave mjedisore"
- Direktiva 2002/49/KE

Në Lejen e Mjedisit Tipi C, në Kushtin 7 janë vënë vlerat kufi që "FENIX.I.C" duhet të zbatojë. Konform UDHËZIMIT Nr. 8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara, subjekti është brenda nivelit të lejuar

**ANEKSI 1**

**NIVELET KUFITË ZHURMËS PËR MJEDISE TË CAKTUARA**

Mjedisi	Efekt i kritik në shëndet	$L_{Aeq}$ (dBA)	Koha bazë (orë)	$L_{Amax}$ Fast (dB)
Zona me aktivitet social ekonomik				
Zona industriale,tegtare, qullimi, trafiku(mjedisi i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim ndigjimi	70	24	100
Jashtë banese	Bezdi(shqetësim) seriozë gjatë ditës dhe mbrëmjes.	55	16	
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	

**Shpjegime:**

LAeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A.

Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja.

LAmx Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën *fast* (e shpejtë)

DREJTUESI I LABORATORIT

MENAXHERI I CILËSISË

**Shpresa BANJA**

**Fuat BANJA**

(vula)

Laboratori LOERMA sh.p.k. **Deklaron se**, ky Raport testimi/analize **nuk mund të riprodhohet** përveç i tërë, pa aprovimin me shkrim të laboratorit.

**FUND RAPORT PROVE**

*INSTRUMENTAT E PËRDORUR PËR MATJEN E PARAMETRAVE CILËSOR  
UJËRAVE, MIKROKLIMËS DHE ZHURMËS.*



*Instrument për matjen e parametrave të ujit.*  
**photoLab 7600**



*Instrument për matjen eparametrave të mikroklimës*  
**TRACEABLE**



*Instrument për matjen e zhurmave.*  
**Cirrus optimus**

**IV. MENAXHIMI I MBETJEVE (KUSHTI 6 I LEJES SË MJEDISIT)**

Mbetjet urbane evadohen nga Bashkia Elbasan. Mbetjet që janë në planin e subjektit për t'i ripërdorur apo ricikluar ruhen brenda territorit sipas kushtit të vënë nga ARM Qarku Elbasan.

**V. KONKLUZIONE:**

Raporti teknik i vlerësimit të zhurmave në mjedis është hartuar duke vlerësuar me objektivizëm të gjitha rezultatet e matjeve të kryera, në ambientet e punës dhe jashtë tyre.

Vlerësohet puna dhe investimet e kryera nga investitori për zhvillimin normal të këtij aktiviteti në drejtim të mbajtjes nën kontroll të të gjithë operacioneve të punës të cilët sjellin ndikime në mjedis, në mbajtjen e vlerave normale të agjentëve kimik, fizik e biologjik në mjediset e punës, të cilët mund të sjellin impakte negative në mjedis. Konstatohen :

- a. Vlera të qëndrueshme dhe normale të mikroklimës në ambientet e brendëshme të punës.
- b. Shkarkimet në ajër janë brenda normave respektive.
- c. Shkarkimet e ujrave në rrjetin e kanalizimit nuk përmbajnë element/ substancë të dëmshme.
- d. Intesiteti i zhurmave të gjeneruara, është nën vlerat e lejuara të mjedisëve urbane.

**VI. REKOMANDIME:**

- Subjekti duhet të kryej matje/ monitorime të shkarkimeve në ajër, ujë dhe tokë si dhe të zhurmave të gjeneruara me një frekuencë prej çdo 6- të muaj.
- Subjekti duhet të kontraktojë me një subjekt ekspert mjedisi dhe laborator të akredituar, për trajtimin e të gjitha çështjeve mjedisore që mund të shfaqen gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij.

Ky Raport, u përgatit nga laborator i subjektit "LOERMA" sh.p.k., i akredituar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit sipas legjislacionit në fuqi.

**SHTATOR 2021**

**ADMINISTRATORI I "LOERMA" SH.P.K.**

**ERMAL BANJA**